



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9374, DATË 21.4.2005, “PËR NDIHMËN SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2018, shqyrtoi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”, propozuar nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit ishte i pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Elton Haxhi dhe përfaqësues nga Departamenti i Legjislacionit dhe i Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave.

Projektligji sëbashku me ndryshimet e propozuara në ligjin për investimet strategjike, prokurimin publik dhe ligjin për turizmin, janë pjesë e paketës së ndryshimeve ligjore që kanë si qëllim ndalimin e përfitimit të të mirave publike nga subjektet e dënuara për një sërë veprash të rënda penale që lidhen me krimin e organizuar, trafikimin dhe terrorizmin dhe korrupsionin.

Falë kësaj pakete dhe me hyrjen në fuqi të ndryshimeve, do u ndalohej çdo lloj mundësie që kjo kategori subjektesh, shoqëri tregtare dhe aksionere dhe përfaqësues të tyre të përfitojnë para nga taksapaguesit shqiptarë apo të përfitojnë mbështetje financiare nga fondet publike për ushtrimin e aktivitetit të tyre fitimprurës.

Në dispozitat e projektligjeve parashikohet që nuk do të mund të përfitojnë ndihmë shtetërore asnjë kompani që jo vetëm rezulton e dënuar si subjekt juridik por dhe në rastet kur të dënuar rezultojnë administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit, ortakët apo aksionerët. I njëjti ndalim do të aplikohet dhe për përfitimin e tenderave publikë, përfitimin e statusit të investitorit strategjik apo lehtësirave në fushën e turizmit.

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Ndryshimet e propozuara janë në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Europian dhe standartet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni mbasi mori në shqyrtim raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e miratoi projektligjin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me ndryshimet e mëposhtme:

Në nenin 1, bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë i pikës 1, riformulohet si vijon:

“1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:”

- Shkronjat “d” dhe “ë”, të pikës 1, riformulohen si vijon:

“d)Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste”;

“ë) Shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.”

- Në pikën 3, togfjalëshi “vërtetim nga dosja gjyqësore” zëvendësohet me togfjalëshin “vërtetim mbi gjendjen gjyqësore”.

RELATORE

KRYETAR

Blerina GJYLAMETI

Erjon BRAÇE